

KONTRATAT KOMERCIALE DHE E DREJTA PRIVATE EVROPIANE

ABSTRAKT

Ky punim diplome është realizuar me synim që në mënyrë koncize dhe të detajuar të ofrojë njohuri të rëndësishme dhe thelbësore rreth kontratave komerciale, duke trajtuar problemet, funksionin, rolin dhe rëndësinë e tyre në të drejtën private evropiane. E drejta komerciale është e drejtë e tregtisë dhe e transaksioneve dhe është kornizë ligjore brenda së cilës zhvillohet e gjithë veprimtaria e biznesit. Për dikë të përfshirë në biznes, në cilindo kapacitet, të kuptuarit e parimeve të së drejtës kontraktore nuk është luks, por domosdoshmëri. Andaj, në këtë punim do t'i kushtohet vëmendje e veçantë të drejtës kontraktore, respektivisht kontratave komerciale, që është një ndër fushat në të cilën mund të vihet re më së shumti ndikimi i të drejtës së Bashkimit Evropian në të drejtën private.

Në pjesën e parë të këtij punimi do të trajtohet qëllimi, struktura, metodat e përdorura gjatë punimit, hyrja, si dhe do të fillohet me shqyrtimin e pjesës së përgjithshme të së drejtës kontraktore evropiane. Në pjesën e dytë, me fokus të veçantë do të ndalem tek kontratat komerciale, ashtu që në mënyrë të detajuar do të shpjegohet funksioni, roli, ndërtimi dhe rëndësia e tyre në të drejtën private evropiane. Në pjesën e tretë të punimit, rëndësi e veçantë do t'i kushtohet tre instrumenteve më të rëndësishëm ndërkombëtarë për rregullimin e transaksioneve komerciale ndërkombëtare: Parimet e Kontratave Komerciale Ndërkombëtare – UNIDROIT, Parimet e së Drejtës Evropiane të Kontratave - PDEK dhe Konventa për Shitjen Ndërkombëtare të Mallrave - KShNM, duke përfshirë gjithashtu edhe Kodin Uniform Komercial. Ndërsa, në pjesën e katërt, përmes metodës komparative (krahasuese) do të analizohet ndikimi i legjislacioneve komerciale evropiane në praktikën komerciale dhe rëndësia e harmonizimit të tyre.

Në fund, poashtu janë dhënë përfundimet dhe rekomandimet, që përfshijnë përmbledhjen e punimit, mendimet dhe vlerësimin personal që i referohen kësaj teme. Gjithashtu janë përdorur edhe metodat përkatëse për hartimin dhe realizimin e një punimi shkencor, të cilat do të elaborohen në vazhdim.

Fjalët kyçe: Kontrata, komerciale, shitjet, tregtari, ndërkombëtare, evropiane.

Mentori: Prof. Dr. Hajredin Kuçi

Kandidate: Albana Oruçi

COMMERCIAL CONTRACTS AND EUROPEAN PRIVATE LAW

ABSTRACT

This thesis was conducted with the aim of concisely and in detail to provide important and essential knowledge about commercial contracts, addressing their problems, function, role and their importance in European Private Law. Commercial law is the law of trade and transactions and is the legal framework within all active business takes place. For someone involved in business, in any capacity, understanding the principles of contract law is not a luxury, but a necessity. Therefore, in this thesis, attention will be given to contract law, respectively to commercial contracts, which is one of the areas in which the influence of European Union Law on private law can be noticed the most.

The first part of this paper will address purpose, structure, methods used during the paper, the introduction, and will begin with a review of the general part of European Contract Law. In the second part, with special focus we will stop on commercial contracts, so in a concise and chronological way will be explained their function, construction, role and importance in European Privat Law. Further, in the third part of this paper, special attention will also be given to the three of most important international instruments for the regulation of international commercial transactions: Principles of International Commercial Contracts - UNIDROIT, Principles of European Contract Law - PECL and Contracts for the International Sale of Goods - CISG, also including the Uniform Commercial Code (U.C.C). Whereas, in the fourth part, through the comparative method will be analyzed the impact of European commercial legislation in commercial practice and the importance of their harmonization.

At the end of this paper, there are also conclusions and recommendations that include the summary of the thesis, opinions and personal assessment that refer to the current topic. The relevant methods have been also used for the drafting and realization of a dissertation, which will be elaborated below.

Keywords: Contract, commercial, sales, trader, international, European.

Mentor: Prof. Dr. Hajredin Kuçi

Candidate: Albana Oruçi